



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 799/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohet BPrAL Kolegji “ESLG” në nivelin institucional për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2021.

II. Riakreditohet programi i studimit për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës, MA, 120 ECTS, (maksimum 50 student për vit akademik).

III. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

IV. Obligohet BPrAL Kolegji “ESLG” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

V. Obligohet BPrAL Kolegji “ESLG” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji “ESLG” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim institucional dhe të programit të studimit me stafin akademik si në vijim:

| Nr. | Programi i studimit | Niveli | ECTS | Bartësit e Programit |
|-----|--|--------|------|--|
| 1 | Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës | MA | 120 | Visar Hoxha, Bashkim Misini, Labinot Greicevci |

AKA ka organizuar vizitë në BPrAL Kolegji “ESLG” më 12.08.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Reinhard Meyers; Ms. Elena Rusnak; Prof. Dr. Aurora Pedro Bueno.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25 Gusht 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji “ESLG”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “ESLG”
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë